

STATUTI I SHOQERISE
"MODIUM STUDIO" SHPK

Bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar dhe ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ne dispozitat e Kodit Civil si dhe ne vullnetin e tij te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e Statutit vendosi te formoje shoqerine:

KREU 1

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot ne date 27/12/2022, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin "MODIUM STUDIO" SHPK

2. Themeluese te shoqerise jane:

1. **MODIUM L.L.C**, e themeluar ne Republiken e Kosoves, më 25/11/2013 në Prishtinë, Republika e Kosovës, me ortake Burim BAJRAKTARI (ID Personale 2170956497) dhe Enis KASUMAJ (ID Personale 1500571426) me Nr. Unik Identifikues: 810833609 dhe adrese: Rr. Jakovë Xoxa, Mati 1, Nr. 5-1, Prishtinë – Republika e Kosovës; Perfaqesuar nga Drejtori Ekzekutiv Enis KASUMAJ ID Personale 1500571426 sipas Autorizimit LRP Nr. Rend 10254/2020 date 28/09/2020
2. **BEKIM BIÇAKU**, shtetas i Republikës së Shqipërisë, i lindur më 23.06.1996 ne Durres , dhe banues me adresë Lagja nr 13, Plazh-Durres ; madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten Leternjoftim ID nr. J60623063H

NENI. 2

OBJEKTI I SHQERISE

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

Per punime dhe per vleresim, projektim, mbikqyrje, kolaudim, per aktivitetet e poshte shenuara. Ndertime Civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshjeve te fasadave, rrugeve, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro hekurudhore me kavo dhe pista aeroportuale, punime nentokesore, ure e vepra arti, diga dhe tunele hodroteknike, ujesjellsa, gazsjellsa, vepra kullimi e vaditje, ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime, ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike, ndertime per nen/stacione, kabinat e transformatoreve, linja TN te mesem dhe shperndarjen e energjise, punime te inxhinierise se mjedisit, hartimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis, punime per prishjen e ndertimeve, impianteve hidrosanitare, kuzhina, lavanderi, mirembajtja e tyre. Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues), punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifinitur te natyres teknike ndertuese, impiante te sinjalistikes ndriquese te trafikut, sinjalistike

jo ndriçuese, 2 barriera dhe mbrojtje rrugore, ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri, punime strukturore speciale, shtresa dhe mbistruktura speciale, punime mbi shina dhe traversa, Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit, impiante dhe linja telefonie, rrjete kabllore me fibra optike per telekomunikacion, impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radio telefoni, TV etj. pastrimi i ujrave detar, liqenore dhe lumore, ndertim i impianteve te ujit te pijshem dhe te pastrimit te tij, ndertim i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Punime topogjeodezike, sistemet kundra zhurmes per infrastrukture, shpime gjeologjike-inxhinierike, puse e shpime per uje, vleresim i pasurive te paluajtshme dhe konsulence ne tregun e shit-blerjeve te pronave. Aktivitet ne fushen e tregtise, tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve te ndryshem industriale, materiale te ndertimit, artikuj te perzier, artikuj ushqimor, elektrike dhe elektroshtepiake, artikujve informatike dhe te telekomunikacionit, pajisje zyresh, import - eksporti i tyre. Rinkonstruksione dhe perforcime te objekteve monument kulture dhe objekteve te rendesive te vecanta. Importe dhe tregti me shumice dhe pakice

NENI. 3

NENI 3 – KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike te shoqerise " MODIUM STUDIO " sh.p.k. është e pakufizuar dhe fillon mbas dates së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimit Tiranë.

NENI 2 – SELIA

Zyra e regjistruar e shoqerise është: Njesia Nr 2, ne Katin perdhe tek Godina 9 Kateshe ,Rruga e Kavajes,Zona kadastale 8220,Nr Pasurie 6/265,Tirane, Shqiperi.Shpenzimet e funksionimit dhe zhvendosjes të Zyres së Shoqërisë në Tirane janë dhe do të mbesin detyrim i Shoqërisë. Vlera e qerase do te percaktohet sipas tregut dhe cmimeve referente.

KREU II KAPITALI

NENI. 5 KAPITALI I THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 (njemilion) leke i investuar ne mase te plote prej 2(dy) Ortakeve ne para. Kapitali Themeltar i Shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuote e barabarte me 100% te kapitalit me vlere 1.000.000 (njemilion) leke e cila do te zotërohet nga dy ortakët e shoqerise:

- **MODIUM L.L.C**, zoteron 1(nje) kuotë , e barabarte me 70 % të kapitalit, e barabarte me vlerë ("700,000") (shtateqindmije) lekë.
- **Bekim BIÇAKU** , zoteron 1(nje) kuotë, e barabarte me 30 % të kapitalit, e barabarte me vlerë ("300,000") (treqindmije) lekë.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta)

NENI. 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kopetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI. 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI. 8

ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimares i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratori perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise

- g) Miratimi i bilanceve
- h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i) Pjestimi e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l) Miraton rregulla procedurale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 51 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.


Nese kuorumit te permendur ne paragrafin e mesiperme nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me 51% e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.



Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqsohet nga nje perfaqses i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te nejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambjela e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKR.

Personat e meposhtem caktohen si Administratoret e shoqerise:

Z **Bekim BIÇAKU**, shtetas i Republikes se Shqiperise, i lindur më 23.06.1996 ne Durres, dhe banues me adresë Lagja nr 13, Plazh-Durres; madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar Leternjoftim ID nr. J60623063H

Z **Enis KASUMAJ**, shtetas i Republikes se Kosoves, i lindur më 08.12.1985 ne Ferizaj, dhe banues me adresë Lagja Gjergj Balsha nr 23; madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar Leternjoftim ID nr. 1500571426

Administratoret do te ushtrojne (neshkruajne sebashku ose dhe vec e vec nga njeri tjetri) te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem te shoqerise, ne perputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Statutin e Shoqerise.

NENI 14
KOPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregtare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise

5



- d) Pergatisin dhe nenshkruajn bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportoje para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne shoqerine bashkerisht, vetem ne rast se statuti ose rregulla te tjera nuk parashikojne te kunderten.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit te shoqerise rregullohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 15 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT


1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere mareveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.

Pervec sa eshte parashikuar ne nenet 14,15, 17, dhe 18 te ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", administratoret detyrohen:

- a) Te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis
- b) Te ushtrojne kopetencat qe i njihen me ligj dhe statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto
- c) Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet , per te cilat merret vendim
- d) Te parandaloje dhe evitoje rastet e konfliktit aktual o te mundshem te interesave te tij me ato te shoqerise
- e) Te ushtrojne detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

2. Administratoret gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

6



3. Nese administratori vepron ne kundershkrim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.
4. Pervet padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Asambleja nuk mund te marre vendim te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij .

KREU IV VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17 EKSPERTET

Shoqeria Audituese LIRENG AUDITING shpk me nipt K92302060P ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i regjistruar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike et ushtruara te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese dhe dorezoje ne kohe ortakeve per tu shqyrtuar e miratuar mbi baze ne te drejtes vendimore qe ka ne perpjestim me kuotat e tyre.

KREU V PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18 PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b) Me vendimet e asamblese se Ortakeve (Ortaku i Vetem)
- c) Me hapjen e procedurave te falimentit
- d) Nese nuk zhvillon aktivitet tregtar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare et Regjistrimit,
- e) Me vendim gjykate.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhejs se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

NENI 20
LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 21
MOSMARRVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kopetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

ORTAKET E SHOQERISE
"MODIUM STUDIO" SH.P.K.



Bekim BIÇAKU

Bekim Bicaku

MODIUM L.L.C

Ortaket

Enis KASUMAJ

ENIS KASUMAJ

Burim BAJRAKTARI

BURIM BAJRAKTARI

Perfaqesuar sipas Autorizimit

LRP.Nr.10254/20020

Drejtori Ekzekutiv

Enis Kasumaj